



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

Prokurori kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtjarit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 6 tetor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Sabit Januzit dhe Ismet Bahtjarit dhe Çështje të lidhura me Të

**Ushtruesit të Detyrës së
Zëvendësprokurorit të Specializuar
Vard Ferdinandse**

**Mbrojtësit (Kujdestar) të Sabit
Januzit**

**Mbrojtësit (Kujdestar) të Ismet
Bahtjarit**

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 20, 21(2), dhe 39(4) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 8(3)(a), 87(6), 92(1) dhe 96 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara ("Rregullorja"), lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 11 shtator 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") paraqiti për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* së bashku me materialet provuese në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat dhe një përmbledhje të detajuar në të cilën tregohet lidhja e secilës provë me secilën aktakuzë.²
2. Më 2 tetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin me të cilin konfirmoi akuzat kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtjarit (përkatësisht, "z. Januzi", "z. Bahtjari", ose "të akuzuarit") për vepra penale sipas nenit 15(2) të Ligjit ("Vendimi i Konfirmimit"),³ fletarrestimet për z. Januzi dhe z. Bahtjari, si dhe urdhrat për transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS").⁴
3. Më 4 tetor 2023, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ("Aktakuza e Konfirmuar").⁵

¹ KSC-BC-2023-10, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 11 shtator 2023, konfidencial.

² KSC-BC-2023-10, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave në lidhje me Të*, 11 shtator 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2023-10, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 2 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00009, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra të Transferimit*, 2 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale.

⁵ KSC-BC-2023-10, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar me Shtojcën 1 Rreptësisht Konfidenciale dhe Ex Parte*, 4 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1,

4. Më 5 tetor 2023, ZPS-ja arrestoi z. Bahtjari në Kosovë.⁶
5. Më 5 tetor 2023, ZPS-ja arrestoi z. Januzi në Kosovë.⁷
6. Më 6 tetor 2023, të akuzuarit u transferuan në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë, Holandë.⁸

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. PARAQITJA E PARË

7. Në bazë të nenit 39(4) të Ligjit, në zbatim të urdhërarrestimit ose fletarrestimit të lëshuar nga DHS-ja, personi kundër të cilit është konfirmuar aktakuzë merret në ndalim, informohet menjëherë për akuzat kundër tij dhe transferohet në Dhomat e Specializuara.

8. Në bazë të rregullave 87(6) dhe 92(1) të Rregullores, i akuzuari nxirret para Gjykatësit të Procedurës Paraprake pa vonesë të papërligjur për paraqitjen e parë.

9. Në bazë të neneve 21(2) dhe 39(6) të Ligjit, seancat, ku përfshihet edhe seanca e paraqitjes së parë të të akuzuarit, janë publike, përveçse kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos ndryshe në përputhje me Rregulloren.

rreptësisht konfidenciale (riklasifikuar si rreptësisht konfidenciale në bazë të udhëzimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në CRSPD1 (Korrespondenca) e 4 tetorit 2023).

⁶ KSC-BC-2023-10, F00011, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Ismet Bahtjarit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁷ KSC-BC-2023-10, F00012, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Sabit Januzit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2023-10, F00014, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Ismet Bahtjarit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00015, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Sabit Januzit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

B. GJUHËT E PUNËS

10. Në bazë të nenit 20 të Ligjit, gjuhët zyrtare të DHS-së dhe ZPS-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja, dhe në proceset gjyqësore, paneli mund të vendosë gjuhët e punës për procesin gjyqësor përkatës, sipas nevojës dhe në përputhje të plotë me të drejtat e të akuzuarit të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit.

11. Në bazë të rregullës 8(3)(a) të Rregullores dhe duke mbajtur parasysh nenin 20 të Ligjit, në fazën më të hershme të mundshme të procesit, pasi t'i ketë dëgjuar palët dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësin e viktimave, paneli merr vendimin se cila ose cilat gjuhë të punës do të përdoren gjatë procesit.

C. KONFERENCA MBI ECURINË E ÇËSHTJES

12. Në bazë të rregullës 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh një konferencë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit, për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykimin; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë përgatitjet e nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes gjyqësore dhe që palëve, e kur është e zbatueshme mbrojtësit të viktimave, t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

13. Në bazë të rregullës 96(2) të Rregullores, konferenca mbi ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit, me praninë e mbrojtësit ose pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës.

III. DISKUTIM

A. PARAQITJA E PARË

14. Duke qenë se z. Bahtjari dhe z. Januzi u arrestuan më 5 tetor 2023 dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHS-së më 6 tetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të arsyeshme të mbajë seancat e paraqitjes së parë të të akuzuarve sa më shpejt që të jetë e realizueshme, për të garantuar respektimin e të drejtave të tyre sipas Ligjit.

15. Gjithashtu, duke pasur parasysh se seancat mund të jenë publike edhe jashtë sallës së gjyqit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon bërjen e fotografive në fillim të secilës seancë të paraqitjes së parë.

B. GJUHËT E PUNËS

16. Duke mbajtur parasysh arrestimin dhe transferimin e të akuzuarve dhe në përputhje me të drejtat e të akuzuarve të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit, është e nevojshme të caktohet gjuha e punës në këtë proces gjyqësor, për të garantuar kryerjen e drejtë, efikase dhe të shpejtë të tij. Për këtë qëllim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron palët që në seancat e paraqitjes së parë, të paraqesin gojarisht mendimet e tyre në lidhje me gjuhën e punës.

17. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se deri më tani, gjuha e punës në këtë proces ka qenë anglishtja, meqenëse të gjitha parashtrimet e ZPS-së dhe Administratores, si edhe vendimet dhe urdhrat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, janë bërë në anglishte. Pasi të ketë marrë mendimet e palëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të vendosë nëse ka arsye bindëse për të mos përdorur anglishten si gjuhë të punës.

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se caktimi i gjuhës së punës së procesit nuk ndikon në gjuhën dhe/ose përkthimin e provave dhe dokumenteve të tjera të nevojshme për përdorim nga të akuzuarit.⁹

C. DATA E KONFERENCËS MBI ECURINË E ÇËSHTJES

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake informon palët se synon të mbajë konferencë mbi ecurinë e çështjes **të enjten, 12 tetor 2023, në orën 14:00**. Mbrojtja ftohet që gjatë seancave të paraqitjes së parë të bëjë të ditur gojarisht nëse mbrojtësit dhe/ose të akuzuarit kanë ndërmend të marrin pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes duke qenë fizikisht të pranishëm ose nëpërmjet videokonferencës, sikurse përcaktohet në rregullën 96(2) të Rregullores.

D. URDHRI PËR RIKLASIFIKIM

20. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se të akuzuarit kanë të drejtën të informohen plotësisht për arsyet e paraburgimit të tyre. Me qëllim që Vendimi mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra të Transferimit (parashtrimi F00009) të jetë sa më shpejt i disponueshëm për të akuzuarit dhe publikun, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që deri **të martën, 10 tetor 2023**, të dorëzojë version të redaktuar konfidencial dhe version të redaktuar publik të Parashtrimit të Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave në lidhje me Të (parashtrimi F00002, pa shtojcat), ose të bëjë të ditur nëse ky parashtrim mund të riklasifikohet si konfidencial ose publik.

IV. VENDIM

21. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **VENDOS** të mbajë seancën e paraqitjes së parë të z. Bahtjari **të hënën, 9 tetor 2023, në orën 14:00**;

⁹ Nenet 21(4)(a) dhe 39(5) të Ligjit; Rregullat 86(8), 87(1), 92(2)(b) dhe 102(1) të Rregullores.

- b) **VENDOS** të mbajë seancën e paraqitjes së parë të z. Januzi të **hënën, 9 tetor 2023, në orën 15:15;**
- c) **AUTORIZON** Administratoren të organizojë, në fillim të secilës prej seancave të paraqitjes së parë bërjen e fotografive për një minutë e gjysmë;
- d) **URDHËRON** palët që në secilën prej seancave të paraqitjes së parë, të paraqesin gojarisht parashtrimet e tyre lidhur me gjuhën e punës që do të miratohet në këtë proces;
- e) **INFORMON** palët se konferenca mbi ecurinë e çështjes do të mbahet **të enjten, 12 tetor 2023, në orën 14:00**, në përputhje me paragrafin 19 të këtij vendimi; dhe
- f) **URDHËRON** ZPS-në që deri **të martën, 10 tetor 2023**, të dorëzojë version të redaktuar konfidencial dhe version të redaktuar publik të Parashtrimit të Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave në lidhje me Të (parashtrimi F00002, pa shtojcat), ose të bëjë të ditur nëse parashtrimi i lartpërmendur mund të riklasifikohet si konfidencial ose publik, sikurse saktësohet në paragrafin 20 të këtij vendimi.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E premte, 6 tetor 2023

Në Hagë, Holandë.